

VENDIM
Nr.788, datë 16.11.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS GRADISHTË, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Gradishtë, të qarkut të Fierit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Gradishtë, miratuar me vendimin nr.131, datë 11.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit, të qarkut të Fierit, të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Gradishtë”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Gradishtë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Gradishtë
Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
13-16	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
17-21	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
22-38	Shërbim funeral	Në pronësi
39	Infrastrukturë	Në pronësi
9-23;185;186	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
40-45,47-56,60; 62-64,66	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
68-98	Prona që përdoren për mbrojtjen civile	Në pronësi
99-126	Pyje kullota	Në pronësi
129-141;176-184	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
187-195	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi
143;145;147;149;151;153;154; 158;159;160;163;167;168;169-175;215; 220;235;242;247;261; 271; 275	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
142;144;146;148;150;152;155; 156;157;161;162;164; 165;166	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

